



Përmbushja e zotimeve elektorale të kryetarëve për qeverisje të mirë

Raport një vjeçar për komunat
Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë
Gjilan dhe Mitrovicë

Janar – Dhjetor 2018



DEMOCRACY PLUS

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Përmbushja e zotimeve elektorale të kryetarëve për qeverisje të mirë

Raport një vjeçar për komunat
Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë
Gjilan dhe Mitrovicë

Janar – Dhjetor 2018



DEMOCRACYPLUS

Përgatitur nga: Roberta Osmani dhe Jetmir Bakija

E drejta e autorit © 2018. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbatja e këtij botimi është përgjegjësi e Demokraci Plus dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbajtja

Hyrje	6
Zotimet për Qeverisje të Mirë Komunale	8
Zotimi 1 – Publikimi i vendimeve, rregulloreve dhe planeve urbane	8
Zotimi 2 – Publikimi i raporteve financiare dhe rezultateve të konkurseve	13
Zotimi 3 – Konsultime publike në lagje dhe fshatra	16
Zotimi 4 – Transparenca në prokurim publik	18
Zotimi 5 – Raporti vjetor për realizimin e premtimeve zgjedhore	21
Zotimi 6 – Adresimi i ankesave qytetare në platforma online	21
Sfidat me ueb faqet e komunave	22
Pasqyra e përmbushjes së zotimeve	24
Aneks 1: Zotimet e nënshkruara nga kandidatët për Kryetarë	28
Aneks 2: Vlerësimi gjashtë mujor i zotimeve	31

Hyrje

Gjatë fushatës elektorale për zgjedhje komunale 2017, Demokraci Plus u ka kërkuar kandidatëve për Kryetar të shtatë komunave që të zotohen formalisht se do t'i përmbahen disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë nëse zgjidhen për të udhëhequr komunën. Inkurajuese ishte fakti se pothuajse të gjithë kandidatët për kryetarë për Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Gjiçani dhe Mitrovica e nënshkruan dokumentin me gjashtë parime bazë të qeverisjes së mirë të quajtur “Gjashtë Zotimet për Qeverisje të Mirë Komunale.” Ndër nënshkruesit e këtyre zotimeve janë edhe kryetarët aktual të këtyre shtatë komunave.

6 ZOTIMET E KRYETARIT PËR QEVERISJE TË MIRË LOKALE

PRISHTINË / PRIZREN / FERIZAJ / PEJË / GJAKOVË / GJILAN / MITROVICË

TË PUBLIKOHEN:



1 Vendimet, Rregulloret Komunale, Planet Urbanistike



2 Raportet e Shpenzimeve dhe Rezultatet e Konkurseve



3 Konsultime Publike në Lagje dhe Fshatra



4 Planet e Prokurimit, Kontratat dhe Konsultime për Planet



5 Raporti Vjetor për Realizimin e Premtimeve Zgjedhore



6 Adresim i Ankesave Qytetare në Platforma Online

Këto gjashtë zotime janë përzgjedhur dhe përpiluar me kujdes nga ekipi i Demokraci Plus duke u bazuar në përvojën e përcjelljes së institucioneve komunale si dhe analizave mbi parimet bazë për Qeverisje të Mirë. Në Aneksin 1 të këtij raporti janë të vendosura zotimet e plota ashtu si janë prezantuar për nënshkrim si dhe nënshkrimet e kandidatëve që janë zotuar se nëse zgjidhen kryetarë do t'iu përmbahen këtyre zotimeve. Qëllimi i këtyre zotimeve është të instalojë një qeverisje komunale të hapur, transparente dhe llogaridhënëse për qytetarët dhe grupet e interesit.

Arsyea pse janë përzgjedhur këto zotime është që të fillohet me disa parime bazë për një demokraci të mirëfillët dhe të kemi përmirësim në këto parime qeverisëse. Disa zotime përfshi publikimin e vendimeve, rregulloreve, planeve urbane, raporteve të shpenzimeve, janë obligim ligjor, ndërsa disa tjera kemi vlerësuar se janë praktikë e qeverisjes së mirë që u ofron qytatrëve komunë të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

Monitorimi i përmbushjes së zotimeve është bërë në baza ditore, ndërsa vlerësimi është bërë në baza tre mujore me një vlerësim të përgjithshëm të të gjitha zotimeve në gjashtë mujorin e parë (periudha janar – qershor 2018), por pa zotimin numër 5 “raporti vjetor për realizimin e premtimeve zgjedhore” për shkak se për këtë element, Kryetarët janë zotuar se do ta publikojnë në fund të vitit të parë të mandatit qeverisës.

Ndërsa shtatë komunat më të mëdha në vend janë përzgjedhur për arsye që përmbushja e zotimeve nga këto komuna do të duhej të shërbej si shembull i mirë për komunat më të vogla përreth në vendosjen e standardeve më të larta të parimeve të qeverisjes së mirë në qeverisjen lokale në Kosovë.

Metodologjia e monitorimit

Pas rezultateve të zgjedhjeve lokale, D+ ka nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me Kryetarët e zgjedhur të shtatë komunave më të mëdha (Prishtina, Prizren, Ferizaj, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Mitrovica), ku janë specifikuar rolet dhe përgjegjësitë e D+ dhe të komunës respektive rreth aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit efektiv të nivelit të zbatimit të zotimeve elektorale.

Si burim i parë për publikim të informatave dhe dokumenteve që përbëjnë gjashtë (6) zotimet, është ueb-faqja e komunës. Me përdorimin e gjerë të internetit dhe teknologjisë informative, ueb-faqet duhet të shërbejnë si mjet primar për të zgjeruar transparencën institucionale.

Për këtë iniciativë monitorimi dhe vlerësimi, D+ ka angazhuar koordinator për secilën nga shtatë komunat, të cilët e bëjnë punën e monitorimit në baza të rregullta ditore në komunën e caktuar. D+ ka zhvilluar metodologjinë e monitorimit që konsiston në monitorimin e drejtëpërdrejtë përmes pjesëmarrjes direkte të koordinatorëve të terrenit, në:

- Seanca të Kuvendeve Komunale;
- Diskutime publike, përfshi: takime me publikun, dëgjime buxhetore, konsultime publike në lagje apo fshatra, konsultime me bashkësitë lokale, dhe konsultime për rregullore;
- Mbledhje të bordit të drejtorëve (në ato komuna ku iu është lejuar qasja koordinatorëve të D+); dhe
- Monitorimit të ueb faqeve zyrtare të komunave për publikim të:
 - Vendimeve të Kryetarit;
 - Vendimeve të Kuvendit Komunal;

- Planeve urbane;
- Raporteve të shpenzimeve;
- Rezultateve të konkurseve;
- Paralajmërimeve për diskutime publike;
- Kontratave;
- Planeve të prokurimit.

Duhet të theksohet se ky monitorim nuk analizon përmbajtjen e këtyre dokumenteve, por thjesht nëse ato janë vendosur ose jo në ueb faqen zyrtare të komunës, ashtu siç janë zotuar Kryetarët.

Gjithashtu, koordinatorët e terrenit janë angazhuar rreth verifikimeve të raportimeve të qytetarëve në platformën ndreqe.com, kanë informuar në baza javore zyrtarët e caktuar nga komuna për raportimet në komunën e tyre, dhe kanë verifikuar intervenimet/rregullimet e ndërmarra nga komuna.

Gjetjet gjatë monitorimit janë regjistruar në baza të rregullta në formularët e zhvilluar nga menaxhmenti i projektit, të cilat pastaj janë analizuar dhe ndarë me komunat respektive dhe publikun në mënyrë periodike.

Zotimet për Qeverisje të Mirë Komunale



Zotimi 1 – Publikimi i vendimeve, rregulloreve dhe planeve urbane

ZOTIMI 1: Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen

Prishtina	☒ Përbushur
Prizren	☒ Përbushur
Ferizaj	☒ Kryesisht i përmbushur
Peja	☒ Përbushur
Gjakova	☒ Përbushur
Gjilani	☐ Nivel i ulët
Mitrovica	☒ Kryesisht i përmbushur

Për shkak të rëndësisë së informimit publik në funksion të transparencës në qeverisjen komunale, zotimi i parë i nënshkruar nga kryetarët aktual është publikimi i shpejtë i vendimeve të Kryetarit dhe Kuvendit Komunal, rregulloreve dhe planeve urbane në ueb faqen zyrtare të komunës. Në përgjithësi, zotimi i parë është përmbushur plotësisht nga katër komuna, kryesisht i përmbushur nga dy komuna dhe me nivel të ulët të përmbushjes nga komuna e Gjilaniit. Vlerësimi është bërë duke marrë parasysh publikimin e vendimeve të Kryetarit dhe të Kuvendit Komunal përfshi ditët mesatare nga marrja deri në publikim, dhe publikimin e planeve urbane në ueb faqe të komunës.

Vendimet e Kryetarit

Në përgjithësi janë publikuar për një kohë të arsyeshme nga shumica e komunave nën monitorim, përveq komunës së Gjilaniit e cila mesataren e ditëve nga marrja deri në publikim të vendimeve e ka 183 ditë, e që gjithashtu është komuna me numrin më të vogël të vendimeve të Kryetarit në vitin 2018 me vetëm 3 vendime. Komuna më e shpejtë në publikimin e vendimeve të Kryetarit është ajo e Prishtinës me zero ditë mesatare nga marrja e vendimit e deri në publikim në ueb faqe. Komnat tjera nën monitorim varijonë me numrin e ditëve mesatare nga 16 deri në 34 ditë. Sa i përket formatit, të gjitha komunat i publikojnë vendimet të skenuara, ndërsa Peja në formatin Word.

Duhet të theksohet se Kryetarët kanë mundur që të marrin një numër më të madh të vendimeve se sa këto të listuara më poshtë, mirëpo në mungesë të bazës së krahasimit, dhe me qëllim të monitorimit të transparencës, në tabelën e mëposhtme paraqiten vetëm ato vendime të cilat janë publikuar në ueb faqe.

Tabela 1: Publikimi i vendimeve të Kryetarit

Vendimet e Kryetarit

Komuna	Numri i vendimeve janar-qershor 2018	Numri i vendimeve janar-dhjetor 2018	Numri mesatar i ditëve nga marrja e vendimit deri në publikim
Prishtina	61	123	0 ditë
Prizren	186	389	24 ditë
Ferizaj	118	201	27 ditë
Peja	92	248	34 ditë
Gjakova	190	331	17 ditë
Gjilani	2	3	183 ditë
Mitrovica	39	103	16 ditë

Vendimet e Kuvendit

Në anën tjetër, numri i vendimeve të marra në Kuvend Komunal është krahasuar me numrin e vendimeve të Kuvendit të publikuara në ueb faqen e komunës. Rregullorja për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, i obligon komunat që të publikojnë aktet normative në ueb faqen e komunës në një afat prej 15 ditësh, pas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nga Ministria përgjegjëse për vetëqeverisjen lokale¹. Nga këto të dhëna shohim se komuna e Gjakovës ka qenë më e shpejta në publikim të vendimeve të Kuvendit, me mesatarisht 15 ditë nga marrja e vendimeve e deri në publikim (në gjashtë mujorin e parë të 2018 gjithashtu ka qenë më e shpejta me mesataren prej 18 ditësh). Ndërsa komuna e Ferizaj mbetet më numrin më të lartë të mesatares së ditëve nga marrja e vendimeve në Kuvend e deri në publikimin e tyre në ueb faqen zyrtare. Megjithatë ka pasur progres në këtë aspekt në gjashtë mujorin e dytë të vitit, sepse mesatarja e periudhës janar-qershor ka qenë 45, ndërsa mesatarja janar-dhjetor ka rënë në 36 ditë. Mesataret e komunave tjera variojnë nga 20 deri në 32 ditë, por në përfundim ka pasur progres në publikim më të shpejtë të vendimeve nga gjashtë mujori i parë në mesataren e gjithë vitit.

¹ Rregullorja nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës. Neni 16: "Publikimi i akteve normative në ueb faqen e komunës".

Tabela 2: Publikimi i vendimeve të Kuvendit

Vendimet e Kuvendit

Komuna	Numri i vendimeve (janar-qershor 2018)	Numri mesatar i ditëve nga marrja deri në publikim (janar-qershor 2018)	Numri i vendimeve (janar-dhjetor 2018)	Numri mesatar i ditëve nga marrja deri në publikim (janar-dhjetor 2018)
Prishtina	26	21 ditë	72	22 ditë
Prizren	16	26 ditë	25	25 ditë
Ferizaj	22	45 ditë	112 (12 të pa publikuara)	36 ditë
Peja	26	23 ditë	51	21 ditë
Gjakova	31	18 ditë	64	15 ditë
Gjilani	26	37 ditë	54 (1 i pa publikuar)	32 ditë
Mitrovica	40	24 ditë	72	20 ditë

Rregulloret

Komuna e Gjilaniit ka miratuar numrin më të madh të rregulloreve në krahasim me gjashtë komunat tjera nën monitorim, konkretisht 11 sosh. Numrin më të lartë mesatar të ditëve nga miratimi deri në publikim të tyre e ka komuna e Ferizajt me 83 ditë, ndërsa komuna me efektivitetet më të lartë në këtë aspekt ka qenë Gjakova me 22 ditë.

Tabela 3: Publikimi i rregulloreve të miratuara

Rregulloret

Komunat	Numri i rregulloreve të miratuara	Numri mesatar i ditëve deri në publikim në ueb faqe
Prishtina	4	24 ditë
Prizren	1	<i>Vetëm draft rregullorja është e publikuar</i>
Ferizaj	4	83 ditë
Peja	2	25 ditë
Gjakova	2	22 ditë
Gjilani	11	48 ditë
Mitrovica	7	26 ditë

Planet urbanistike

Planet urbane janë ndër aktet më të rëndësishme komunale dhe paraqesin interes publik për shkak se tregojnë si rregullohen lagjet dhe fshatrat ku qytetarët banojnë dhe si pritët të duken ato në të ardhmen. Andaj publikimi i tyre në ueb faqe të komunës është pjesë e zotimit të parë për Qeverisje të Mirë komunale. D+ ka monitoruar nëse komunat në fokus i kanë të publikuar gjatë kësaj periudhe planet urbane që janë aktualisht në fuqi dhe jo vetëm ato që mund të jenë miratuar në këtë periudhë qeverisëse pasi që këto plane janë afat-mesme dhe afat-gjata.

Tabela 4: Publikimi i planeve urbane

Planet urbane

Komuna	Numri i planeve
Prishtina	23
Prizren	4 (por hapen vetëm në ueb faqen e vjetër)
Ferizaj	Nuk ka
Peja	13
Gjakova	9 (asnjë nuk është i qasshëm)
Gjilani	Nuk ka
Mitrovica	Nuk ka

Prishtina prin me numrin më të madh të planeve të publikuara (23), duke u ndjekur pas nga Peja (13) dhe Gjakova (9). Prizreni dhe Gjakova kanë respektivisht 4 dhe 9 plane të publikuara por nuk janë të qasshme në ueb faqet e reja zyrtare.

Komunat e tjera nën monitorim nuk kanë plane urbane të publikuara ne ueb faqe dhe banorët e tyre nuk kanë mundësi të marrin informata të shpejta dhe në mënyrë praktike nga ueb faqja e komunës për planin afatgjatë se si do të zhvillohet komuna dhe në bazë të tyre ta planifikojnë banimin, aktivitetet biznesore, shkollimin etj.



Zotimi 2 – Publikimi i raporteve financiare dhe rezultateve të konkurseve

ZOTIMI 2: Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen

Prishtina	☒ Kryesisht i përmbushur
Prizren	☒ Kryesisht i përmbushur
Ferizaj	☒ Kryesisht i përmbushur
Peja	☒ Përmbushur
Gjakova	☒ Përmbushur
Gjilani	☒ Kryesisht i përmbushur
Mitrovica	☒ Kryesisht i përmbushur

Një tjetër parim i Qeverisjes së Mirë për të cilin janë zotuar kryetarët aktual në kohën kur ishin kandidatë për pozitë, është transparenca në shpenzimin e buxhetit komunal, konkretisht publikimi në ueb faqe në baza të rregullta dhe në kohë të arsyeshme, raportet tre mujore financiare. Ky zotim në fakt, është edhe obligim ligjor². Poashtu, Kryetarët janë zotuar se do të jenë transparent me konkursat publike të komunës, duke i publikuar në ueb faqe rezultatet e të gjitha konkurseve.

Raportet financiare apo raportet e shpenzimeve, janë pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve të komunës për çdo tre muaj të vitit, dhe kjo informatë është tejet e rëndësishme për shkak se tregon sa ka arritur zyra e Kryetarit të mbledh të hyrat e planifikuara për atë tre-mujor dhe si e ka shpenzuar buxhetin e miratuar nga Kuvendi në atë periudhë. Si i tillë pra është një vlerësim se ku qëndron komuna në çdo periudhë tre-mujorëshe dhe në varësi të kësaj situate, bëhet planifikimi i mëtutjeshëm i aktiviteteve të komunës. Për më tepër është çështje me interes edhe për publikun dhe taksapaguesit të cilët kanë të drejtë të jenë të informuar se si shpenzohet paraja publike nga komuna e tyre në mënyrë periodike.

² Ligji Nr. 03/L-48 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 45: "Raportet tremujore buxhetore".

Tabela 5: Publikimi i raporteve të shpenzimeve

Raportet e shpenzimeve

Komuna	Tre mujori i I-rë (Janar – Mars)	Tre mujori i II-të (Janar – Qershor)	Tre mujori i III-të (Janar – Shtator)	Tre mujori i IV-të (Janar – Dhjetor)
Prishtina	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar
Prizren	Publikuar	Publikuar (në vendin e gabuar në ueb)	Publikuar (në vendin e gabuar në ueb)	
Ferizaj	Jo	Jo	Publikuar (në vendin e gabuar në ueb)	Publikuar
Peja	Publikuar (vetëm për janar dhe shkurt)	Publikuar (raporte mujore)	Publikuar	Publikuar
Gjakova	Publikuar (në vendin e gabuar në ueb)	Publikuar (në vendin e gabuar në ueb)	Publikuar	Jo
Gjilani	Jo	Publikuar	Publikuar (në vendin e gabuar në ueb)	Raporte mujore deri në nëntor 2018
Mitrovica	Jo	Jo	Publikuar	Jo

Edhe pse në përgjithësi të shtatë komunat nën monitorim e kanë përmbushur këtë zotim, gjatë monitorimit kemi hasur në disa çështje rreth praktikave të publikimit të këtij raporti të cilat e bëjnë sfiduese punën e qytetarit në marrjen e këtyre informatave. E para, është fakti që vendi i publikimit të tyre brenda ueb faqes varion nga komuna në komunë. Disa komuna e vendosin atë tek vegëza e Investimeve Kapitale, disa në vegëzën e Drejtorisë së Financave. Në fakt në ueb faqet e reja është përcaktuar që ky raport të vendoset tek Investimet Kapitale, gjë për të cilën vlerësojmë se është çorientues sepse nuk në fakt nuk është investim kapital por raport për shpenzimet e komunës. E dyta, është fakti që disa komuna e paraqesin atë në baza tre mujore ashtu siç edhe kërkohet, ndërsa disa të tjera e paraqesin në baza mujore, por në përgjithësi ka vonesa në publikim të këtij raporti. E treta, sa i përket formatit të tij, disa paraqesin dokumente të skenuara që ka pasur raste të jenë të pa lexueshme, disa në formatin excel, e kështu me rradhë. Përveq formatit, ka edhe variacion në informatat që prezantohen në raportet financiare e që ungesa e konsistencës e bën të vështirë krahasimin mes komunave.

Përveç publikimit të raportit në ueb-faqe, raporti financiar duhet të dërgohet në Kuvend për informim dhe shqyrtim. Vlerësimi i parë për përmbushje të këtij zotimi është bërë me datën 7 maj 2018, për raportin janar-mars 2018, i cili do të duhej të ishte i publikuar një muaj pas përfundimit të periudhës dhe i dorëzuar tek Kuvendet respektive për informim dhe shqyrtim, siç kërkohet edhe me ligj.

Sa i përket rezultateve të konkurseve, është monitoruar numri i rezultateve të publikuara në ueb faqen e komunës. Nga komunat nën monitorim, Prishtina dhe Mitrovica kanë numër të konsiderueshëm të rezultateve të pa publikuara, ndërsa komunat tjera qëndrojnë mirë me respektimin e këtij zotimi.

Tabela 6: Publikimi i rezultateve të konkurseve

Rezultatet e konkurseve

Komuna	Publikimi i rezultateve
Prishtina	28 të publikuara, 18 të pa publikuara, 4 të anuluar
Prizren	26 të publikuara
Ferizaj	39 të publikuara, 1 i pa publikuar
Peja	10 të publikuara
Gjakova	88 të publikuara
Gjilani	9 të publikuara
Mitrovica	31 të publikuara, 16 të pa publikuara



Zotimi 3 – Konsultime publike në lagje dhe fshatra

ZOTIMI 3: Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen

Prishtina	 Nivel i ulët
Prizren	 Kryesisht i përmbushur
Ferizaj	 Përmbushur
Peja	 Përmbushur
Gjakova	 Kryesisht i përmbushur
Gjilani	 Përmbushur
Mitrovica	 Gjysmake

Një qeverisje e mirë kërkon që të konsultojë qytetarët për çështjet që i ndikojnë ata drejtpërdrejtë dhe për informim të vazhdueshëm të tyre. Konsultimet e rregullta me qytetarët qoftë për buxhet, apo për çështje specifike me rëndësi për banorët, por edhe takimet publike për informim të qytetarëve janë esenciale për një qeverisje të përgjegjshme, efektive dhe gjithëpërfshirëse. Në fakt, mbajtja e të paktën dy takimeve publike është obligim ligjor për komunat³ por nga qeveritë komunale pritet të kenë edhe konsultime me qytetarë për çështje dhe procese specifike si buxheti, planet urbane dhe rregulloret për fusha të ndryshme nën kompetencë të komunës.

³ Ligj Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale. Kreu IX “Demokracia e Drejtëpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes Qytetare”. Neni 68: “Informimi publik dhe konsultimi”. Gazeta Zyrtare, 2008.

Tabela 7: Konsultimet publike, lloji dhe numri

Konsultime Publike

Komuna	Numri i konsultimeve të mbajtura	Lloji i diskutimeve
Prishtina	17	2 takime publike në Kuvend Komunal; 6 dëgjime buxhetore (të gjitha në Kuvend Komunal); 7 takime publike për tema të veçanta. 2 konsultime për rregullore;
Prizren	33	1 takim publik në Kuvend Komunal; 8 dëgjime buxhetore (6 në Kuvend Komunal, 2 në fshatra); 12 takime me qytetarë për harta zonale (9 në lagje të qytetit, 3 brenda komunës); 10 takim për tema të ndryshme (përfshi KAB)
Ferizaj	24	2 takime publike në Kuvend Komunal; 10 dëgjime buxhetore (1 në Kuvend Komunal, 1 në lagje të qytetit, 8 në fshatra); 9 konsultime me qytetarë për harta zonale; 2 diskutime për rregullore; 1 takim mes Kryetarit dhe mërgimtarëve;
Peja	24	2 takime publike në Kuvend Komunal; 13 dëgjime buxhetore (2 në Kuvend Komunal, 2 në lagje, 9 në fshatra); 5 konsultime për rregullore, plan të punës dhe projektligj; 4 diskutime tjera të ndryshme;
Gjakova	15	2 takime publike në Kuvend Komunal; 10 dëgjime buxhetore (1 në Kuvend Komunal, 1 në lagje të qytetit, 8 në fshatra); 2 konsultime nga drejtoritë; 1 takim në zyre të Drejtorisë së Urbanizmit.
Gjilani	21	2 takime publike në Kuvend Komunal; 10 dëgjime buxhetore (2 në Kuvend Komunal, 1 në lagje të qytetit dhe 7 në fshatra); 7 konsultime për rregullore; 2 takime me rini;
Mitrovica	9	2 takime publike në Kuvend Komunal; 7 dëgjime buxhetore (3 në Kuvend Komunal dhe 4 në fshatra);

Komuna e Prizrenit ka mbajtur numrin më të madh të konsultimeve publike në vitin 2018, por vetëm njërin nga dy takimet obligative për punën gjashtë mujore të komunës. Kjo komunë i ka konsultuar qytetarët për hartën zonale, buxhetin përfshi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, sigurinë publike, banimin social, ndër të tjerash. Pas Prizrenit, dy komuna me një numër të madh të konsultimeve publike janë Peja dhe Ferizaji me nga 24 takime. Këto komuna përveq dy takimeve obligative në të dy gjashtë mujorët, kanë mbajtur edhe një numër të konsiderueshëm të dëgjimeve buxhetore nga të cilat shumica në lagje dhe fshatra, dhe konsultime për çështje tjera me interes si rregullore dhe harta zonale. Edhe në vlerësimin e gjashtë mujorit të parë të vitit 2018, Peja ka pasur numrin më të madh të diskutimeve publike me 17 diskutime të mbajtura, nga të cilat nëntë (9) kanë qenë në lagje të qytetit dhe tetë (8) nëpër fshatra. Komuna e Ferizajit nga katër diskutime që i ka mbajtur nga janari deri në qershor, deri në fund të vitit ka arritur t'i mbajë 24 në total. Komuna e Gjakovës dhe e Mitrovicës edhe pse e kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e takimeve publike në të dy gjashtë mujorët, mbesin dy komunat me numrin më të vogël të diskutimeve të mbajtura.



Zotimi 4 – Transaparenca në prokurim publik

ZOTIMI 4: Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen

Prishtina	☒ Kryesisht i përmbushur
Prizren	☐ Gjysmake
Ferizaj	☐ Gjysmake
Peja	☒ Kryesisht i përmbushur
Gjakova	☒ Kryesisht i përmbushur
Gjilani	☐ Gjysmake
Mitrovica	☐ Nivel i ulët

Në fushën e prokurimit publik, për qëllimet e këtij vlerësimi dhe bazuar në zotimet elektorale të Kryetarëve, D+ i ka vlerësuar komunat nëse kanë plan të prokurimit të publikuar dhe të qasshëm në ueb faqet e tyre zyrtare, nëse i bëjnë publike kontratat dhe nëse mbajnë konsultime publike për planet e prokurimit.

Konsultimet për plane të prokurimit dhe publikimi i tyre

Sa i përket zotimit për mbajtjen e konsultimeve publike për planet e prokurimit, edhe pse nuk është obligim ligjor, Kryetarët janë zotuar se do t'i mbajnë ato. Megjithatë, në vitin e parë qeverisës, ky zotim pati ngecje në realizim nga të gjitha komunat nën monitorim sepse asnjëra nuk ka mbajtur konsultime të tilla.

Ky zotim është i rëndësishëm për shkak se komunat mund të marrin rekomandime nga sektori privat dhe qytetarët në lidhje me kohën kur do të bëhet realizimi i projekteve të caktuara. Kjo përveq se e rrit numrin e rekomandimeve që komuna mund të marrë në lidhje me kohën e realizimit të projekteve, gjithashtu e rrit edhe informimin e qytetarëve për investimet që do të pasojnë. Kjo praktikë ndihmon në akomodimin e nevojave dhe planifikimit të sektorit privat, sidomos kur është në plan ndonjë investim i madh në hapësire publike. Mirëpo, asnjëra nga shtatë komunat nuk i është përmbajtur këtij zotimi.

Për shkak të konkurrencës së drejtë dhe të barabartë për të gjithë komunitetin e biznesit, është parim i mirë që planet e prokurimit të publikohen në fillim vit për vitin aktual. Në fakt, nga muaji janar 2018, autoritete kontraktuese, në këtë rast komunat, janë të obliguara ta publikojnë planin e prokurimit për vitin aktual në ueb faqe, 15 ditë pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal⁴. Megjithatë vetëm dy nga shtatë komunat e mëdha e kanë publikuar këtë plan në muajtë e parë të 2018–ës (Prishtina dhe Gjakova e kanë publikuar në shkurt). Sidoqoftë, pasi që ky obligim ka hyrë në fuqi në mes të vitit 2018, është sukses që gjashtë nga shtatë komunat nën monitorim i kanë këto plane në ueb faqet e tyre, edhe pse disa me vonesë të konsiderushme.

Tabela 8: Planet e prokurimit dhe mbajtja e konsultimeve për to

Prokurimi publik

Komuna	Konsultime publike për planet	Plane të prokurimit	Kur është publikuar plani i prokurimit për vitin 2018
Prishtina	JO 	PO 	Shkurt 2018
Prizren	JO 	PO 	Shtator 2018
Ferizaj	JO 	PO 	Gusht 2018
Peja	JO 	PO 	Prill 2018
Gjakova	JO 	PO 	Shkurt 2018
Gjilani	JO 	PO 	Korrik 2018
Mitrovica	JO 	JO 	–

Nga vlerësimi i kaluar (janar–qershor 2018) ka progres të dukshëm në lidhje me këtë zotim sepse deri në qershor 2018 vetëm dy nga të shtatë komunat kanë plane të prokurimit të publikuara në ueb faqe në vendin e caktuar për dokumente të prokurimit publik.

Është e rëndësishme të ceket se njëri nga elementet e këtij zotimi – publikimi i kontratave nuk ka qenë obligim ligjor në kohën kur janë nënshkruar zotimet, megjithatë është pritur nga Kryetarët që ta mbajnë zotimin se do t'i përmbahen këtij parimi të Qeverisjes së Mirë. Por ndryshimin e rregullores “Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik” publikimi i kontratave të nënshkruara është bërë obligim ligjor për të gjitha autoritetet kontraktuese. Ky progres i madh në fushën e transparencës së prokurimit publik, ka filuar nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u ndjekur pas nga komuna tjera.

⁴ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Janar 2012.

Duke i krahasuar njoftimet për nënshkrim nga platforma e e-prokurimit dhe kontratat e vitit 2018 të publikuara në ueb faqet e komunave, kemi arritur në numrin e kontratave të pa publikuara nga komunat respektive. Edhe pse publikimi i kontratave është praktikë e re dhe rishtazi e kërkuar me legjislacion, komunat nën monitorim i kanë shumicën e kontratave të publikuara. Dallim të theksuar në mes të dhënave të platformës së e-prokurimit dhe ueb faqes, ka në komunën e Prizrenit.

Tabela 9: Publikimi i kontratave

Publikimi i kontratave

Komuna	Njoftimet për kontratat e nënshkruara në e-prokurim	Kontratat e publikuara në ueb faqe	Diferenca – kontratat e pa publikuara
Prishtina	134	133	1
Prizren	164	108	56
Ferizaj	52	51	1
Peja	64	55	9
Gjakova	111	102	9
Gjilani	68	66	2
Mitrovica	33	26	7



Zotimi 5 – Raporti vjetor për realizimin e premtimeve zgjedhore

ZOTIMI 5: Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen

Prishtina	Pa përmbushur
Prizren	Pa përmbushur
Ferizaj	Gjysmake
Peja	Pa përmbushur
Gjakova	Pa përmbushur
Gjilani	Pa përmbushur
Mitrovica	Pa përmbushur

Pasi që asnjë nga kryetarët që janë zotuar se do të publikojnë raportin vjetor për progresin e realizimit të premtimeve zgjedhore nuk e ka publikuar atë deri në mes të janarit 2019, D+ u ka dërguar kryetarëve kërkesa për përmbushje të këtij zotimi. Përveq komunës së Ferizajit e cila e ka publikuar një përmbledhje me të arriturat në secilën fushë të qeverisjes lokale të udhëhequr nga Kryetari, të titulluar “200 punë konkrete për Ferizajin dhe ferizajasit”, dhe për këtë ky zotim i është vlerësuar si gjysmë i përmbushur. Mirëpo, zotimi i kryetarëve ka qenë që do të bëhet një raport për gjitha premtimet zgjedhore, përfshi ato që ende nuk janë realizuar apo filluar, si dhe ato premtime që janë në proces apo që kanë ngecje në implementim për çfarëdo arsye. Asnjë komunë tjetër nuk e ka përmbushur këtë zotim, ndërsa përgjigja e komunës së Mitrovicës është se Kryetari aktual nuk ka bërë asnjë premtim elektorale në fushatën e fundit zgjedhore.



Zotimi 6 – Adresimi i ankesave qytetare në platforma online

ZOTIMI 6: Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen

Prishtina	☒ Kryesisht i përmbushur
Prizren	☒ Kryesisht i përmbushur
Ferizaj	☐ Gjysmake
